INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO SIPAS RAJONEVE STATISTIKORE NË SHQIPËRI

2024


INSTAT publikon të dhënat e Produktit të Brendshëm Bruto sipas rajoneve statistikore, për vitin 2024 dhe seritë e përditësuara për periudhën 2000-2023, pjesë e rishikimit të Llogarive Kombëtare realizuar në Qershor 2026. Rishikimi i Produktit të Brendshëm Bruto sipas rajoneve përfshin integrimin e rezultateve të Cens të Popullsisë dhe Banesave 2023, përmirësimin e metodologjive të vlerësimit dhe harmonizimin e mëtejshëm me standardet evropiane.

Në vitin 2024, sipas rajoneve statistikore në nivel 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korrente u vlerësua 2.517.279 milionë Lekë, duke shënuar një rritje në terma realë 4,03 % krahasuar me vitin 2023.

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2024, e ka dhënë Qarku Tiranë me +3,24 pikë përqindje, pasuar nga Qarku Durrës me +0,29 pikë përqindje dhe Qarku Vlorë me +0,15 pikë përqindje.

Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e kanë dhënë Qarqet: Dibër, Kukës dhe Shkodër me +0,01 pikë përqindje.

FIG.1 KONTRIBUTI I QARQEVE NË RRITJEN EKONOMIKE, VITI 2024



Ecuria e Produktit të Brëndshëm Bruto sipas rajoneve statistikore në nivel 2 (rajoni) paraqitet si më poshtë:

Për publikim 05/11/2026

- Rajoni Veri shënoi rritje në terma realë 1,60 %, krahasuar me vitin 2023, duke zënë 21,68 % në strukturën e PBB-së gjithsej për vitin 2024;
- Rajoni Qendër shënoi rritje në terma realë 6,43 %, krahasuar me vitin 2023, duke zënë 52,87 % në strukturën e PBB-së gjithsej për vitin 2024;
- Rajoni Jug shënoi një rritje reale 1,31 %, krahasuar me vitin 2023, duke zënë 25,45 % në strukturën e PBB-së gjithsej për vitin 2024;

Sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark), rritjen reale më të lartë të PBB-së e shënoi Qarku Tiranë me rritje në terma reale 7,08 %, i ndjekur nga Qarku Durrës me 2,82 % dhe Qarku Vlorë me 2,53 % të PBB-së krahasuar me vitin 2023.

Rritjen reale më të ulët të PBB-së e shënoi Qarku Shkodër me 0,19 %, Qarku Dibër me 0,27 % dhe Qarku Fier me 0,57 %.

TAB. 1 PBB SIPAS RAJONEVE STATISTIKORE


Kodi	Niveli Statistikor 2 / 3	PBB çmime korente (milion Lekë) 2023	PBB çmime korente (milion Lekë) 2024	Struktura ndaj PBB-së 2023	Struktura ndaj PBB-së 2024	Rritja Reale e PBB-së 2024/2023	Kontributi ndaj rritjes Reale 2024/2023
AL0	**Republika e Shqipërisë**	**2.365.186**	**2.517.279**	**100,0**	**100,0**	**4,03**	**4,03**
AL01	**Veri**	**522.913**	**545.622**	**22,11**	**21,68**	**1,60**	**0,35**
AL011		61.473	64.410	2,60	2,56	0,27	0,01
AL012	Durrës	245.821	258.479	10,39	10,27	2,82	0,29
AL013	Kukës	33.248	34.625	1,41	1,38	0,63	0,01
AL014	Lezhë	68.040	70.525	2,88	2,80	1,19	0,03
AL015	Shkodër	114.331	117.583	4,83	4,67	0,19	0,01
AL02	**Qendër**	**1.226.913**	**1.330.886**	**51,87**	**52,87**	**6,43**	**3,34**
AL021	Elbasan	144.946	149.373	6,13	5,93	1,56	0,10
AL022	Tiranë	1.081.967	1.181.513	45,75	46,94	7,08	3,24
AL03	**Jug**	**615.361**	**640.771**	**26,02**	**25,45**	**1,31**	**0,34**
AL031	Berat	82.071	85.601	3,47	3,40	1,56	0,05
AL032	Fier	235.069	243.725	9,94	9,68	0,57	0,06
AL033	Gjirokastër	49.506	51.713	2,09	2,05	1,32	0,03
AL034	Korçë	112.174	116.548	4,74	4,63	1,20	0,06
AL035	Vlorë	136.541	143.183	5,77	5,69	2,53	0,15

2024 Të dhëna finale

PBB për frymë sipas niveleve statistikore

Në vitin 2024, niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor nivel 1 (Republika e Shqipërisë), vlerësohet 1.059 mijë Lekë.

FIG.2 PBB PËR FRYMË SIPAS RAJONEVE STATISTIKORE NIVEL 3, VITI 2024 (000/LEKË)



2024 Të dhëna finale

Në vitin 2024, sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin statistikor Veri, PBB për frymë është 853 mijë Lekë duke u vlerësuar 19,45 % nën mesataren e vendit. Në rajonin statistikor Qendër, PBB për frymë është 1.347 mijë Lekë dhe vlerësohet 27,19 % mbi mesataren e vendit. Në rajonin statistikor Jug, PBB për frymë është 855 mijë Lekë dhe vlerësohet 19,25 % nën mesataren e vendit.

Në vitin 2024, niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark), u regjistrua në Qarkun Tiranë, me 1.556 mijë Lekë duke u vlerësuar 46,98 % mbi mesataren e vendit. Pas tij renditet Qarku Durrës me PBB për frymë 1.152 mijë Lekë, duke u vlerësuar 8,81 % mbi mesataren e vendit dhe Qarku Fier me 1.034 mijë Lekë, 2,40 % nën mesataren e vendit.

Niveli më i ulët i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark) në vitin 2024, u vlerësua në Qarkun Kukës me rreth 568 mijë Lekë dhe PBB për frymë e këtij qarku vlerësohet 46,32 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në për frymë më të ulët vijon Qarku Dibër me 610 mijë Lekë dhe PBB për frymë e këtij qarku vlerësohet 42,38 % nën mesataren e vendit dhe qarku Berat me 613 mijë Lekë. PBB për frymë e këtij qarku vlerësohet 42,15 % nën mesataren e vendit.

TAB. 2 PBB PËR FRYMË SIPAS RAJONEVE STATISTIKORE, 2024

Kodi	Niveli Statistikor 2/3	PBB për frymë (mijë Lekë)	Indeksi ndaj PBB-së (%)
AL0	**Republika e Shqipërisë**	**1.059**	**100,00**
AL01	**Veri**	**853**	**80,55**
AL011	Dibër	610	57,62
AL012	Durrës	1.152	108,81
AL013	Kukës	568	53,68
AL014	Lezhë	723	68,32
AL015	Shkodër	777	73,35
AL02	**Qendër**	**1.347**	**127,19**
AL021	Elbasan	652	61,58
AL022	Tiranë	1.556	146,98
AL03	**Jug**	**855**	**80,75**
AL031	Berat	613	57,85
AL032	Fier	1.034	97,60
AL033	Gjirokastër	877	82,78
AL034	Korçë	686	64,79
AL035	Vlorë	988	93,32

2024 Të dhëna Finale

TAB.3 STRUKTURA E VLERËS SË SHTUAR BRUTO SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË DHE RAJONEVE STATISTIKORE (DEGA = 100 %), VITI 2024

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime korente
AL	**Republika e Shqipërisë**	**100,00**	**100,00**	**100,00**	**100,00**	**100,00**	**100,00**	**100,00**	**100,00**	**100,00**	**100,00**	**100,00**
AL01	**Veri**	**27,86**	**29,35**	**18,64**	**22,03**	**8,47**	**24,30**	**23,02**	**13,77**	**15,82**	**17,58**	**21,68**
AL011	Dibër	5,71	3,87	2,28	1,06	0,60	3,29	1,27	0,80	2,11	0,45	2,56
AL012	Durrës	6,80	16,54	9,56	13,51	4,09	9,81	12,85	8,73	5,25	10,92	10,27
AL013	Kukës	2,91	1,23	0,60	0,99	0,67	1,89	0,98	0,41	1,94	0,35	1,38
AL014	Lezhë	4,75	2,59	2,36	2,58	0,45	4,93	3,33	0,88	2,51	1,81	2,80
AL015	Shkodër	7,70	5,12	3,84	3,88	2,66	4,39	4,59	2,95	4,00	4,04	4,67
AL02	**Qendër**	**16,08**	**45,62**	**62,43**	**58,03**	**85,07**	**46,11**	**54,85**	**76,69**	**66,78**	**69,57**	**52,87**
AL021	Elbasan	11,61	8,01	5,30	3,62	1,57	5,82	5,49	1,84	4,98	2,31	5,93
AL022	Tiranë	4,47	37,62	57,13	54,41	83,50	40,28	49,36	74,85	61,80	67,26	46,94
AL03	**Jug**	**56,05**	**25,02**	**18,93**	**19,94**	**6,46**	**29,59**	**22,14**	**9,54**	**17,41**	**12,85**	**25,45**
AL031	Berat	9,18	2,95	2,08	2,10	1,18	5,62	2,22	0,75	2,28	1,14	3,40
AL032	Fier	24,97	11,68	6,16	5,88	2,33	7,64	7,20	3,27	4,97	4,08	9,68
AL033	Gjirokastër	3,14	2,30	1,91	1,61	0,36	3,14	1,47	1,24	2,34	1,17	2,05
AL034	Korçë	10,23	3,95	2,33	4,20	1,06	6,05	4,47	1,39	3,86	2,64	4,63
AL035	Vlorë	8,54	4,14	6,45	6,14	1,54	7,14	6,78	2,90	3,96	3,81	5,69

2024 Të dhëna Finale

TAB.4 STRUKTURA E VLERËS SË SHTUAR BRUTO SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË DHE RAJONEVE STATISTIKORE (RAJONI = 100 %), VITI 2024

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesional e dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime korente
AL	**Republika e Shqipërisë**	**17,68**	**12,81**	**14,11**	**21,82**	**2,80**	**1,82**	**5,84**	**7,96**	**13,10**	**2,06**	**100,00**
AL01	**Veri**	**22,73**	**17,35**	**12,13**	**22,17**	**1,10**	**2,04**	**6,20**	**5,06**	**9,56**	**1,67**	**100,00**
AL011	Dibër	39,47	19,36	12,55	9,08	0,66	2,34	2,91	2,48	10,79	0,36	100,00
AL012	Durrës	11,70	20,64	13,14	28,70	1,12	1,74	7,31	6,77	6,70	2,19	100,00
AL013	Kukës	37,35	11,41	6,16	15,69	1,36	2,49	4,17	2,37	18,46	0,53	100,00
AL014	Lezhë	29,95	11,86	11,90	20,12	0,45	3,20	6,93	2,50	11,76	1,33	100,00
AL015	Shkodër	29,15	14,06	11,59	18,12	1,60	1,71	5,74	5,02	11,23	1,78	100,00
AL02	**Qendër**	**5,38**	**11,06**	**16,66**	**23,94**	**4,51**	**1,59**	**6,06**	**11,55**	**16,54**	**2,71**	**100,00**
AL021	Elbasan	34,60	17,28	12,60	13,32	0,74	1,79	5,40	2,47	10,99	0,80	100,00
AL022	Tiranë	1,68	10,27	17,17	25,29	4,99	1,56	6,14	12,70	17,24	2,95	100,00
AL03	**Jug**	**38,93**	**12,59**	**10,49**	**17,09**	**0,71**	**2,12**	**5,08**	**2,99**	**8,96**	**1,04**	**100,00**
AL031	Berat	47,72	11,13	8,63	13,50	0,98	3,00	3,81	1,75	8,78	0,69	100,00
AL032	Fier	45,59	15,46	8,98	13,24	0,67	1,44	4,34	2,69	6,72	0,87	100,00
AL033	Gjirokastër	27,02	14,33	13,14	17,15	0,49	2,78	4,18	4,80	14,94	1,18	100,00
AL034	Korçë	39,05	10,93	7,09	19,81	0,64	2,38	5,63	2,38	10,91	1,17	100,00
AL035	Vlorë	26,54	9,32	16,01	23,56	0,76	2,28	6,97	4,06	9,12	1,38	100,00

2024 Të dhëna Finale

Shënim për përdoruesit:

- *Të dhënat janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: PBB Rajonale*
- *Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme: https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimit-te-gabimeve.pdf*

Metodologjia

Ky publikim paraqet rezultatet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2024 në Republikën e Shqipërisë sipas rajoneve statistikore në nivel 1, 2 dhe 3, të përcaktuara sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian, si dhe degëve të ekonomisë sipas nomenklaturës NVE Rev 2.

Llogaritë Kombëtare Rajonale bazohen në metodologjinë ESA 2010, kryesisht te Kapitulli 13, duke marrë si bazë vlerësimet më të fundit të Llogarive Kombëtare Vjetore të publikuara më 29 Qershor 2026, në mënyrë që të ruhet konsistenca e këtyre treguesve.

Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e treguesve rajonalë mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993. Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare rajonale. Përditësimet e klasifikimeve bëhen që treguesit ekonomikë rajonalë të jenë më të dobishëm për përdoruesit, në mënyrë që të pasqyrojnë zhvillimet ekonomike dhe të përmirësojnë krahasueshmërinë e të dhënave midis rajoneve dhe vendeve anëtare të BE-së bazuar në Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian.

Parimi i Rezidencës

Parimi kryesor për alokimin e VSHB-së në Llogaritë Rajonale është se Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) duhet të alokohet në rajonin ku njësia prodhuese është rezidente, pra që do të thotë se VSHB shpërndahet në rajonin ku krijohet.

Ndryshimet në vlerësimet e Llogarive Kombëtare Vjetore kanë reflektuar dhe në Llogaritë Rajonale si në të dhëna dhe në metodologji. INSTAT ka bërë një ndryshim cilësor në zhvillimin e metodave në vlerësimin e VSHB-së rajonale për ndarjen e veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve dhe institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë kryesore në një apo më shumë rajone. Në lidhje me metodologjinë e përdorur konsultohuni me materialin: "Metodologjia e Llogarive Rajonale në Shqipëri" në adresën e mëposhtëme:

https://www.instat.gov.al/media/4639/material-metodologjik-llogarit%C3%AB-rajonale.pdf

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare Rajonale janë:

- Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike REV.2 (NVE Rev.2).
- Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS).

Nomenklatura e njësive territoriale për statistikat (NUTS) është një klasifikim i përbashkët, në bazë të të cilit mblidhen dhe përpunohen, statistikat rajonale evropiane.